



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **81**

Prishtinë, më 22.8.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Mungoi : Nijazi Idrizi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga të ftuarit e rregullt.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 13.7.2012,
3. Shqyrtimi i planit të punës me projektet në sesionin vjeshtor,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.7.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.7.2012.

3. Shqyrtimi i punës së komisionit në sesionin vjeshtorë

Kryetari i Komisionit fillimisht rikujtoi komisionin për mbledhjen e fundit në sesionin pranveror ku janë caktuar detyrat për komisionin dhe grupet punuese, ndërsa duke uruar punë të mbarë në sesionin vjeshtor ai sugjeroi që komisioni të vazhdoi punën sidomos në ato çështje ku janë mbetur pa përfunduar siç janë monitorimi i ligjit për VNM dhe VSM dhe monitorimet tjera, për çka kërkoi nga stafi të hartoi planin e realizimit të tyre ngase tani duhet të ndryshon koha e realizimit për shkak se kanë mbetur mbrapa. Ai gjithashtu ftoi anëtarët prezent që në cilësinë e deputetit të ngrenë zërin për hyrjen në fuqi të Ligjit për deputetët përkatësisht për privilegjet e deputetëve, ngase më në fund duhet të sqarohet se një deputet a gëzon disa privilegje apo nuk i gëzon. **Daut Haradinaj** mbështeti këtë kërkesë duke kërkuar realizimin nga MPB (sidomos gjatë qarkullimit të deputetëve me automjete).

Liburn Aliu premtoi se kah mesi i shtatorit do të angazhohet që të jetë i përfunduar raporti për Ligjin e VNM por sa i përket Ligjit për VSM tha se duhet të kontaktohen zyrtarët e REC ngase ata kanë marr pjesë në ato monitorime. Stafi u angazhua të kërkoi njoftimin nga REC a ekziston ushtruesi i detyrës së kryesuesit në këtë organizatë, në mënyrë që grupi punues i komisionit të vazhdoi punën rreth monitorimit të Ligjit për VSM.

Sa i përket ligjeve tjera në komision, **Kryetari i Komisionit** potencoi faktin se Agjencia e pyjeve ka kërkuar të hiqen 500 ha nga Sharri, pastaj të shpallet parku. Në këtë temë u involvua edhe **Daut Haradinaj** i cili shprehu pakënaqësinë rreth ruajtjes së pyjeve, ngase ato vazhdimisht shkatërrohen me zjarre të qëllimshme në emër të pastrimit të pyjeve duke kontribuar kështu të përforcohet krimi i organizuar dhe masakrimi i pyjeve (për shembull shkon Agjencia të pastroi 30 ha ndërsa i shkatërrohen edhe 30 ha të tjera në prezencë të policisë). Ai shtoi se duhet të mbështetet popullata në Restelicë dhe andej me ndonjë projekt ose subvencion ngase asgjë nuk kanë, ndërsa për Bjeshkët e Nemuna tha se ky projektligj nuk mund të bëhet Ligj ngase është një përshkrues e jo ligj.

Liburn Aliu u angazhua për zbatimin e përvojave nga Austria dhe Polonia, ngase shteti duhet ta blejë zonën strikte nëse është në pronë private, gjithashtu ishte i mendimit se dëmet në pyje më tepër bëhen nga Agjencia sesa nga popullata lokale. **Sevdije Lama** potencoi se me këto projekte nuk është bërë zonimi, çka gjithashtu paraqet vështirësi. Në vazhdim u zhvilluan diskutimet më të hollësishme në mes Daut Haradinaj, Liburn Aliu dhe Nait Hasanit rreth disa çështjeve të rëndësishme për parqe, si p.sh. tërheqja e Maqedonisë pas demarkacionit të kufinjve rreth ndërtimit të hidrocentralit tek lumi Radika, etj.

Nait Hasani sugjeroi që ti dërgohet raporti me vërejtje MMPH, MBPZHR, MPB dhe Agjencisë së Pyjeve për mungesë të aktiviteteve të duhura gjatë djegëses së pyjeve të cilat ngjasojnë zjarreve të qëllimshme (dyshohet se zjarret ndodhin për të dalur bari i ri) duke përkrahur fuqimisht divizionin e zjarrfikësve.

Komisioni përcolli rekomandimet për projektligjin e pasurimit të miellit, të cilat rekomandime në seancën e fundit janë përcjellur urgjentisht, ndaj për shkak se seanca e fundit është ndërprerë, tani rekomandimet u plotësuan në mënyrën e rregullt tabelare duke shtuar te Amendamenti 7 fjalën “numri 1000 bëhet 1500” (e cila vërejtje teknike është dashur të bëhet në rekomandimin e fundit). Kryetari sugjeroi që nuk ka nevojë të miratohet vërejtja e UNICEF për të ndryshuar fjalën “certifikatë” me fjalën “raport” te Neni 11 pika 5.1. ngase është më përfshirëse.

Kryetari i Komisionit përfundoi mbledhjen duke propozuar mundësinë e takimit të Komisionit më 31 gusht për të shikuar mundësinë e intervenimit të Komisionit rreth djegëjeve të pyjeve tek ministritë përkatëse ose përmes medieve për shkak të mosangazhimeve të duhura si dhe rreth Ligjit për privilegjet e deputetëve.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani

